



Universiteti i Elbasanit
"ALEKSANDËR XHUVANI"

**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I HISTORI - GJEOGRAFISË**

organizon

**KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE:
100 VJET NGA REPUBLIKA PARLAMENTARE
SHQIPTARE (1925-2025)**

Partnerë: Universiteti i Tiranës - Universiteti "Hasan Prishtina", Fakulteti i Filozofisë, Prishtinë - Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti "Nënë Tereza", Shkup, Maqedoni e Veriut - Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit - Instituti Albanologjik i Prishtinës - Universiteti i Bolonjës - Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër - Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës - Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër - Universiteti "Fan Noli", Korçë

Kjo Konferencë Shkencore, e organizuar nga Universiteti i Elbasanit në kuadër të 100-vjetorit të Republikës Shqiptare, synon të mbledhë bashkë historianë, akademikë dhe studiues për të përkujtuar dhe për të reflektuar mbi zhvillimet historike, politike dhe sociale të kësaj faze të rëndësishme të historisë së shtetit shqiptar. Duke e parë këtë jubile si një mundësi më tepër për të evidentuar arritjet dhe sfidat e kësaj periudhe, në një moment kyç të historisë sonë shqiptare, kur domosdoshmëria për të formuar një shtet modern e të qëndrueshëm dhe institucione demokratike dolën në plan të parë, ky aktivitet vjen si një nga format e dimensionet e përkujdesjes mbi këtë trashëgimi historiko- shkencore, mbi rrugën e përshkruar nga populli shqiptar dhe elita politike drejtuese e saj, gjatë viteve 1925 -1928, periudhë e shkurtër, por e rëndësishme e shekullit XX.

Qëllimi i konferencës është të ofrojë një mundësi për të çuar më tej arritjet e studimeve shumëvjeçare shqiptare, si edhe për të promovuar hulumtimet shkencore mbi bazën e qasjeve të reja, të thelluara në drejtim të ndikimit të 100 viteve të Republikës Parlamentare në aspektin e zhvillimit politik, institucional dhe shoqëror të Shqipërisë, sikurse edhe ndikimet që ka pasur kjo periudhë në rajon. Sjellja e përvojave dhe analizave që mund të pasurojnë literaturën historike për periudhën e Republikës, shkëmbimi i ideve dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mes studiuesve të fushave të ndryshme, do të shërbejnë për të hedhur dritë mbi zhvillimet e kësaj periudhe historike duke kontribuar për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar e vlerave të shtetit shqiptar.

Konferenca shkencore është në vazhden e nismave të ndërmarra nga Departamenti i Histori - Gjeografisë dhe Fakulteti i Shkencave Humane, që ndër të tjera synojnë të ofrojnë një platformë për diskutime dhe analiza shkencore, duke nxitur kërkuesit, studiuesit e rinj si edhe studentët të prezantojnë punimet e tyre shkencore, duke shënuar një hap më tej në kuadër të zhvillimit dhe thellimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore, studimore e më gjerë.

Fushat kryesore dhe temat bosht të konferencës:

Republika Shqiptare dhe rruga drejt konsolidimit të regjimit republikan

- Rikthimi në pushtet i Ahmet Zogut dhe vendosja e regjimit republikan. Faktorët që ndikuan në rikthimin e tij.
- Karakteri kushtetues - juridik i Republikës Shqiptare.
- Situata e brendshme politike, mbështetja dhe kundërshtitë ndaj Ahmet Zogut. Masat për shtrirjen e autoritetit të shtetit në vend dhe sigurimin e regjimit.

Organizimi i institucioneve dhe reformat e ndërmarra

- Institucionet shtetërore republikane, organizimi, roli dhe efektet e veprimitarisë së tyre.
- Pushteti lokal dhe riorganizimi i tij në vitet e Republikës Shqiptare.
- Ndikimi i Republikës Parlamentare Shqiptare në konsolidimin e shtetit shqiptar.

Jeta ekonomike dhe sociale në periudhën e Republikës

- Jeta ekonomike dhe politika e ndjekur në vitet 1925 - 1928; reformat e ndërmarra në sektorët e ndryshëm të ekonomisë.
- Krijimi i sistemit financiar të shtetit shqiptar - Banka Kombëtare e Shqipërisë.
- Sektori i transportit, i komunikacionit dhe shërbimi Postë - Telegrafeve.

Zhvillimet arsimore dhe kulturore

- Arsimi e kultura shqiptare në periudhën republikane. Masat dhe reformat e ndërmarra në këto fusha dhe rezultatet e tyre.
- Komunitetet fetare, organizimi i tyre dhe qëndrimi i shtetit shqiptar.
- Mendimi intelektual shqiptar në vitet '20 - '30 të shekullit XX.
- Pozita e gruas dhe reformat e ndërmarra nga shteti shqiptar.

Marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit shqiptar në vitet e Republikës

- Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë në vitet e Republikës. Marrëdhëniet me Italinë, përparësi e politikës së jashtme të Qeverisë Shqiptare.
- Vlerësimet e diplomacisë së huaj për Republikën Shqiptare dhe qeverisjen e kësaj periudhe.
- Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj shqiptarëve jashtë trojeve dhe diasporës shqiptare.
- Kalimi nga Republikë në Monarki dhe zhvillimet e reja të viteve '30 të shekullit XX.

Prefektura Elbasan në vitet e Republikës Shqiptare

- Mjedisi intelektual elbasanas në prag të shpalljes së Republikës shqiptare.
- Zhvillimet, politike, administrative, ekonomike, kulturore, sociale në Prefekturën e Elbasanit.
- Tradita arsimore në Elbasan dhe rrezatimi i saj në hapësirën mbarë shqiptare.
- Popullsia, natyra dhe mjedisi i Elbasanit në vitet "20 - "30 të shekulli XX. Asetet e turizmit të tij dhe trashëgimia infrastrukturore e kulturore.
- Figura, personalitete, vlera dhe kontribute të mjedisit elbasanas në periudhën e Republikës Shqiptare.

- Bordi shkencor i konferencës do të bëjë vlerësimin e punimeve, mbështetur në përputhshmërinë e tyre me fushat e temave të përcaktuara, origjinalitetin dhe qartësinë e të shkruarit. Punimet e pranuar do të botohen në Përmbledhjen e konferencës, me indeksin ISBN.
- Pjesëmarrja në konferencë është pa pagesë.
- Një autor ose bashkautor nuk mund të përfshihet në konferencë me më shumë sesa dy punime.
- Prezantimi i punimeve mund të bëhet fizikisht ose virtualisht, në platformën online.
- Gjuha e konferencës: Shqip / Anglisht.

Data të rëndësishme

- | | |
|---------------------------|-------------------------------------|
| » 1 mars, 2025 | Dorëzimi i abstrakteve |
| » 5 mars, 2025 | Njoftimi për pranimin e abstrakteve |
| » 12-13 mars, 2025 | Datat e konferencës |
| » 30 maj, 2025 | Dorëzimi i punimeve të plota |

 Dërgimi i punimeve do të bëhet në: **konferenca.fshh@uniel.edu.al**

 Vendi: Korpusi Qëndror, Universiteti i Elbasanit

Do ju ishëm mirënjohës nëse ju e shpërndani këtë **Thirrje** me të tjerë kolegë, bahkëpunëtorë të njohur e interesuar të fushës dhe tematikës.

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

Abstrakti: Abstrakti i punimeve të paraqitura duhet të dërgohet në gjuhën shqipe dhe anglisht. Abstrakti duhet të tregojë qartësisht qëllimin e kërkimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës, dhe me seksionin përkatës, qasjen e përdorur, rezultatet kryesore të kërkimit dhe rëndësinë e tyre.

Përmbajtja e abstraktit: 250 – 400 fjalë (12pt Times New Roman, Bold, Justify, Hapësira mes rreshtave 1.5) dhe të paraqesë qëllimin dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe rekomandimet.

Titulli i punimit: 14 pt Times New Roman, Bold, i qendëruar, me shkronja të mëdha.

Emrat e autorëve: Emri i plotë i autorit (autorëve), statusi, institucioni dhe adresa e-mail për secilin prej autorëve. (Me shkronja të mëdha, 12 pt Times New Roman, në qendër. Institucioni ose Departamenti dhe Universiteti (12 pt Times New Roman, në qendër. E-mail(për komunikim) 12pt Times New Roman, në qendër, i rrafshuar në të dy skajet).

Fjalët kyçe: 5-7 fjalë të renditura në rend alfabetik (12pt Times New Roman, Normal). Fjalët kyç është mirë që të përmbledhin temën, nëntemën, llojin e studimit, popullatën, vendin e zbatimit të studimit.

Formati: Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word, shkrimi në formatin A4, lloji i gërmës: 12 pt., font - Times New Roman.